



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

14-D20/05-40979/25, më 24 MAR 2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, shkronja (b) të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/15 qershor 2008), nenit 7 nën paragrafi 3.2 të dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-111 për Arkivat dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

**V E N D I M**

1. Arkivi Komunal i Prishtinës mbetet arkiv i Fondkrijuesit – Komunës së Prishtinës, si institucion i Kryeqytetit i përcaktuar në fushëveprimin e Ligjit për Arkiva.
2. Institucioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi vepron në kuadër të Sektorit të Arkivit të Kryeqytetit dhe e ushtron veprimtarinë në objektin e Arkivit Komunal të Prishtinës.
3. Fondkrijuesi si institucion i Kryeqytetit krijon materialin arkivor në pajtim me legjislacionin në fuqi, i cili dërgohet për arkivim në arkivin kompetent pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**I DORËZOHET:**

- Drejtorisë së Administratës;
- Qendrës për shërbime me qytetarë; dhe
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
**Përparim Rama**

